

Nr. 10/1 Prot
30/01/2018
KONFERENCA PËR MBARËKOMBËTARI I ENJGJASTRIOTTI SKENCOR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 4M/1 Prot.

Tiranë, më 30.01. 2018

URDHËR

Nr. 39, datë 30.01.2018

PËR
MIRATIMIN E STATUTIT TË KOLEGJIT UNIVERSITAR "I BIZNESIT"

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Statutit të Kolegjit Universitar "I Biznesit", propozuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 83 datë 14.10.2017, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri (33 faqe).
2. Të gjitha rregulloret dhe aktet e tjera Kolegjit Universitar "I Biznesit" të miratohen në zbatim të Statutit të Kolegjit Universitar "I Biznesit", dhe kuadrit ligjor në fuqi.
3. Kolegji Universitar "I Biznesit", brenda afatit ligjor, të paraqesë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të gjitha aktet dhe dokumentacionin ligjor për organet dhe autoritetet drejtuese, personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, sipas përcaktimeve të këtij statuti.
4. Ndryshimet në statutin e Kolegjit Universitar "I Biznesit" miratohen sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi dhe këtij statuti.
5. Statuti i Akademisë Profesionale të Biznesit, shfuqizohet.
6. Statuti i Kolegjit Universitar "I Biznesit" hyn në fuqi, pas hyrjes në fuqi të këtij urdhri.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Arsimit Rinisë dhe Sportit dhe Kolegji Universitar "I Biznesit".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

LINDITA NIKOLLA





**KOLEGJI
UNIVERSITAR I BIZNESIT**

STATUTI

I

INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË JOPUBLIK

KOLEGJI *UNIVERSITAR*

“I BIZNESIT”



KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Veprimtaria e Kolegjit Universitar "I BIZNESIT"

1. Kolegji *Univeristar* "I BIZNESIT" është Institucion Jopublik i Arsimit të Lartë, i llojit KOLEGJ UNIVERSITAR, më poshtë (KU), që ushtron veprimtari në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive profesionale dhe atyre krijuese, në fushën e ekonomisë dhe drejtësisë.
2. KU "I BIZNESIT" në të gjitha korrespondecat në gjuhën angleze do të përdojë emërtimin: "University College of Bussines".
3. Emërtimi i shkurtuar në gjuhën shqipe, për këtë statut dhe në marrëdhënie me të tretët, do të jetë "KUB", ndërsa në gjuhën angleze do të jetë "UCB".
4. KU "I BIZNESIT" është person juridik privat, që ushtron veprimtari ekonomike në formën e një shoqërie tregtare me emrin "Kolegji Universitar i BIZNESIT", i njohur nga ligjislacioni Civil dhe Tregtar Shqiptar, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (QKR), me NIPT. L02401014C.
5. KU "I BIZNESIT" ka nisur aktivitetin si institucion i arsimit të lartë jopublik me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.651, datë 14.09.2011 "Për Licencimin e Akademisë Profesionale të Biznesit".

Neni 2

Baza ligjore

Ky Statut mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", si dhe aktet nënligjore në fuqi.

Neni 3

Selia

KU "I BIZNESIT" e ka selinë në rrugën "Vangjel Noti" nr.25, Laprakë, Tiranë, Kodi Postar 1026.

Neni 4

Misioni

KU "I BIZNESIT" ka për mision të:

- a. formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend.



- b. krijojë, zhvillojë, përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, veprimtarive inovative e profesionale për fushën e Ekonomisë dhe Drejtësisë.
- c. ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimit i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- d. integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor;
- e. nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë.
- f. krijojë dhe mbështesë standartet më të larta në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në përputhje me Standartet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL), duke reflektuar objektivat e procesit të Bolonjës.

Neni 5

Laiciteti i KU "I BIZNESIT"

KU "I BIZNESIT" është Institucion i Arsimit të Lartë jopublik, kombëtar dhe laik.

Neni 6

Liria akademike dhe autonomia e KU "I BIZNESIT"

1. KU "I BIZNESIT", gëzon autonomi akademike, autonomi financiare, organizative si dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSh.
2. Liria akademike garantohehet nëpërmjet parimit të së drejtës për:
 - a. të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese e profesionale;
 - b. të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore;
 - c. të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik.
3. Autonomia financiare garantohehet nëpërmjet parimit të së drejtës për:
 - a. të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies;
 - b. të Realizuar veprimtari kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore dhe rregullative të institucionit;
 - c. të përfituar fonde nga organizma të tjerë;
 - d. të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit;
 - e. të përcaktuar tarifat e studimit;
 - f. të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që institucioni zotëron ligjërisht, në përputhje me misionin e tij.
4. Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohehet nëpërmjet parimit të së drejtës për:
 - a. t'u vetëqeverisur, për të zgjedhur organizmat drejtues, për të organizuar strukturat akademike dhe administrative;



- b. të rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë nëpërmjet akteve të brendshme, të hartuara në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSh;
- c. të caktuar kritere për pranimin e studentëve në programet e studimit;
- d. të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, kualifikuese, kërkimore-shkencore, inovative, si edhe veprimtarive të tjera të ligjshme;
- e. të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe për të përcaktuar pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit.

Neni 7

Vendosja e marrëdhënjëve institucionale

1. Institucioni i arsimit të lartë jopublik KU "I BIZNESIT" gëzon të drejtën e vendosjes së marrëdhënieve me institucione kombëtare dhe të huaja të arsimit të lartë, me qëllim bashkëpunimi dhe shkëmbim të përvojave akademike e shkencore etj.
2. Institucioni i arsimit të lartë jopublik KU "I BIZNESIT" ka të drejtën e anëtarësimit në shoqata e organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.
3. Ai bashkëpunon me organizata joqeveritare të huaja që ndihmojnë në zhvillimin e arsimit të lartë.
4. Institucioni i arsimit të lartë privat KU "I BIZNESIT" hyn në marrëdhënie me universitete dhe institucione të tjera jashtë vendit, publike ose private, për zhvillimin dhe modernizimin e programeve të studimit dhe të procesit mësimor, si dhe në ndërtimin e marrëdhënieve ligjore për realizimin e programeve të përbashkëta me ta, deri në lëshimin e diplomave të përbashkëta apo të dyfishta.

Neni 8

Paprekshmëria e mjediseve

1. KU "I BIZNESIT" e zhvillon veprimtarinë në mjedise me qira, ose që janë në pronësi të shoqërisë KU "I BIZNESIT". Këto mjedise nuk lejohet të preken apo të cenohen nga të tretë, përveç rasteve të parashikuara konform kuadrit ligjor në fuqi. Paprekshmëria e mjediseve të veprimtarisë përfshin moslejimin e ndërhyrjes në to apo të përdorimit të tyre nga çdo person tjetër.
2. Ndërhyrja e organeve të rendit publik në mjediset e KU "I BIZNESIT", bëhet me leje ose me kërkesë nga Rektori, përveç rasteve të fatkeqësive natyrore dhe të kryerjes së krimeve të rënda, sidomos të atyre kundër jetës.
3. Për çdo rast cenimi të paprekshmërisë së mjediseve të Institucionit, KU "I BIZNESIT" i lind e drejta e denoncimit të shkeljes dhe kërkimit të ndëshkimit të shkelësit sipas dispozitave ligjore në fuqi.



KREU II STRUKTURA ORGANIZATIVE

Neni 9

Njësitë përbërëse

KU "I BIZNESIT" përbëhet nga njësi kryesore, njësi bazë, njësi ndihmëse dhe njësi administrative, sipas Shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij statuti.

Neni 10

Njësitë kryesore

Njësitë kryesore të KU "I BIZNESIT" janë:

- a. Fakulteti i Ekonomisë;
- b. Fakulteti i Drejtësisë.

Neni 11

Funksionet e njësive kryesore

1. Fakulteti i Ekonomisë është njësi kryesore që bashkërendon veprimtarinë mësimore dhe atë kërkimore-shkencore si dhe veprimtaritë me karakter profesional dhe krijues në fushën e ekonomisë. Fakulteti i Ekonomisë ofron programe të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve të cilat janë hapur dhe akredituar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Fakulteti i Drejtësisë është njësi kryesore që bashkërendon veprimtarinë mësimore dhe atë kërkimore shkencore si dhe veprimtaritë me karakter profesional dhe krijues në fushën e drejtësisë. Fakulteti i Drejtësisë ofron programe të studimeve, të cilat janë hapur dhe akredituar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 12

Njësitë bazë

Secila Njësi Kryesore e KU "I BIZNESIT" organizohet në tre njësi bazë (departamente).

Neni 13

Funksionet e njësive bazë

1. Departamenti është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të fakultetit, që përfshin fusha kërkimi të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore respektive. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron.



2. Departamenti nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore, në varësi të llojit të institucionit.
3. Departamenti ka në përbërje të tij të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore ose tituj akademikë. Departamenti mund të ketë në përbërje dhe personel ndihmës akademik.
4. Departamenti mund të organizohet në grupe mësimore dhe në grupe të përhershme ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor, në përputhje me llojin dhe misionin e institucionit.
5. Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve të cilësisë.
6. Departamenti propozon kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Departamenti për zgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, sipas procedurave të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë.
7. Departamenti mund të ofrojë shërbime për të tretët si dhe të zhvillojë veprimtari të tjera, sipas legjislacionit në fuqi dhe rregullave të përcaktuara në statutin dhe aktet e tjera të institucionit të arsimit të lartë.
8. Departamenti menaxhon fondet bazë të kërkimit shkencor apo fonde të tjera që gjenerohen nga burime të ligjshme, publike ose jopublike, kombëtare ose ndërkombëtare.
9. Rregulla të tjera për strukturën dhe funksionimin e departamentit përcaktohen në rregullore.

Neni 14

Hapja, riorganizimi dhe mbyllja e njësive kryesore dhe atyre bazë

1. Hapja e njësive kryesore të institucioneve të arsimit të lartë, riorganizimi ose mbyllja e tyre bëhen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin, në bazë të propozimit të institucionit të arsimit të lartë, pas miratimit të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit
2. Hapja, riorganizimi ose mbyllja e njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë bëhen me vendim të Senatit Akademik, në përfundim të vitit akademik, pas miratimit të Bordit të Administrimit. Institucioni i njofton vendimin e tij ministrisë përgjegjëse për arsimin brenda një afati tridhjetëditor.

Neni 15

Njësitë ndihmëse dhe administrative

1. Njësitë ndihmëse të KU "I BIZNESIT" janë:
 - a. Zyra e Marrëdhënieve me jashtë;
 - b. Zyra e Marrëdhënieve me publikun;



- c. Zyra e Njesisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC);
 - d. Sekretaritetë mësimore;
 - e. Laboratori i informatikës;
 - f. Biblioteka;
 - g. Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës;
 - h. Zyra e kurrikulave;
2. Njësitë administrative të KU “I BIZNESIT” janë:
- a. Zyra e Administratës, Burimeve njerëzore dhe arkivit;
 - b. Zyra e Programimit dhe Raportimit Financiar;
 - c. Sektori mbështetës

KREU III

ORGANIZIMI AKADEMIK

Neni 16

Organet drejtuese akademike, organet e tjera kolegjiale dhe autoritetet drejtuese

1. Organet drejtuese akademike të KU “I BIZNESIT” janë:
 - a. Senati akademik;
 - b. Asambleja e Personelit Akademik;
 - c. Komisionet e përhershme.
2. Organet e tjera akademike kolegjiale të KU “I BIZNESIT” janë:
 - a) Rektorati;
 - b) Dekanati;
 - c) Këshilli i Etikës
3. Autoritetet drejtuese të KU “I BIZNESIT”, janë:
 - a. Rektori;
 - b. Drejtuesi i njësisë kryesore;
 - c. Drejtuesi i njësisë bazë.

Neni 17

Senati akademik

1. Senati është organi më i lartë drejtues akademik i institucionit, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij.
2. Senati përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët përfaqësojnë njësitë kryesore të KU “I BIZNESIT” dhe studentët. Anëtarë të tij janë: Rektori, dekanët, 1 (një) anëtar i zgjedhur i këshillit studentordhe të tjerë pedagogë që gëzojnë grada/tituj akademikë, që dalin nga procesi i zgjedhjeve. Modalitetet e zgjedhjeve të anëtarëve më përjashtim të rektorit, dekanëve dhe studentit, përcaktohen në rregulloren e Institucionit.
3. Senati kryesohet nga rektori dhe mbledhet periodikisht.
4. Anëtarët e senatit i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së, në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull dhe, për efekt të përfaqësimit, kategoria e



- tyre mund të zbresë, deri në gradën shkencore “Doktor” të fituar në Republikën e Shqipërisë.
5. Senati mblidhet me kërkesë të Rektorit në mbledhje të zakonshme jo më pak se katër herë në vit. Rendi i ditës propozohet nga Rektori dhe materialet u vihen në dispozicion anëtarëve të Senatit jo më vonë se 15 ditë para datës së zhvillimit të mbledhjes. Me miratimin e Rektorit, në rendin e ditës, mund të përfshihen për shqyrtim edhe çështje të tjera, të cilat propozohen nga anëtarët e Senatit.
 6. Senati mund të mblidhet edhe në mbledhje të jashtëzakonshme me kërkesën e Rektorit. Rendi i ditës i propozuar dhe materialet për diskutim, vihen në dispozicion të anëtarëve, jo më vonë se 3 ditë nga data e zhvillimit të mbledhjes.
 7. Senati i zhvillon mbledhjet e tij nëse sigurohet kuorumi i nevojshëm prej 2/3-ën e anëtarëve dhe merr vendime me shumicën e anëtarëve të pranishëm.
 8. Mandati i anëtarit të senatit është 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje. Mandati ndërpritet para përfundimit kur anëtari i senatit:
 - a. denohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b. jep dorëheqjen si anëtar senati;
 - c. është në pamundësi për të kryer detyrën;
 - d. janë konstatuar shkelje të rënda të ligjit ose Kodit të Etikës;
 - e. kur nuk është më pjesë e KU “I BIZNESIT”,
 9. Ndërpreja e mandatit konstatohet me vendim të shumicës prej 2/3 të anëtarëve të Senatit.
 10. Zëvendësimi i anëtarëve të larguar bëhet me rregullat si dhe të pranimit dhe nga e njëjta kategori. Mandati i anëtarit zëvendësues është mandat plotësues.

Neni 18

Funksionet e Senatit Akademik

Senatit akademik ka këto funksione:

- a. garanton autonominë e institucionit, lirinë akademike, si dhe të drejtat e studentëve;
- b. propozon planin strategjik të zhvillimit të institucionit;
- c. miraton statutin e institucionit me dy të tretat e votave të anëtarëve të tij, pasi të jetë marrë miratimi paraprak i Bordit të Administrimit;
- d. zgjedh rektorin;
- e. harton strukturën e përgjithshme të institucionit të arsimit të lartë dhe i propozon Bordit të Administrimit numrin e personelit akademik të institucionit në të gjitha nivelet;
- f. miraton rregulloret e institucionit dhe aktet e tjera, sipas përcaktimeve të bëra në statut;
- g. miraton programet e reja të studimit, të kërkimit shkencor, ndryshimet si dhe mbylljen e tyre. Programet e reja të studimit duhet të jenë të mbështetura në projektbuxhetin vjetor të institucionit;
- h. propozon mbylljen dhe riorganizimin e institucionit të arsimit të lartë, si dhe ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë me një institucion tjetër të arsimit të lartë;



- i. miraton hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive të institucionit mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë. Në këto raste merr vlerësimin paraprak të Bordit të Administrimit;
- j. miraton propozimin për hapjen e filialeve apo njësive brenda dhe/ose jashtë vendit.
- k. miraton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore;
- l. Miraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, të hartuar nga rektorati, dhe ia përcjell atë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- m. zgjedh përfaqësuesit e tij në Bordin e Administrimit;
- n. miraton paraprakisht planin buxhetor vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit;
- o. garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë;
- p. krijon mekanizmat për vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore të personelit akademik;
- q. organizon mbledhjen e përbashkët, në bashkëpunim me Bordin e Administrimit, në fund të çdo viti akademik, ku diskutohet për veprimarinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe atë financiare;
- r. miraton ndryshime profilizuese deri në masën 20 për qind në programet e studimit të akredituara dhe njofton ministrinë përgjegjëse për këto ndryshime jo më vonë se gjashtë muaj para fillimit të vitit akademik.

Neni 19

Asambleja e Personelit akademik

1. Asambleja e personelit akademik përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë të njësive kryesore.
2. Asambleja e personelit akademik krijon dhe zgjedh anëtarët e komisioneve të përhershme të njësive kryesore.

Neni 20

Komisionet e përhershme

1. Komisionet e përhershme janë organe kolegjiale.
2. Komisionet kryejnë funksione në fushat që lidhen kryesisht me garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit, me mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij dhe marrëdhëniet me studentët, në përputhje me misionin dhe politikën e institucionit.
3. Komisionet e përhershme krijohen në nivel institucional dhe në nivel të njësisë kryesore me vendim të Asamblesë së personelit akademik të njësisë kryesore.
4. Komisionet përbëhen prej jo më pak se pesë anëtarësh me mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
5. Anëtarët e Komisioneve në nivel institucional vetë kandidohen dhe zgjidhen nga Asambleja e personelit akademik të njësisë kryesore.



Neni 21

Rektorati

1. Rektorati është organ kolegjal që drejtohet nga rektori. Ai përbëhet nga :
 - a. Rektori;
 - b. Administratori i institucionit;
 - c. Drejtuesit e njësive kryesore.
2. Rektorati ka këto funksione:
 - a. harton planin strategjik të zhvillimit të institucionit, mbështetur në propozimet e njësive bazë, kryesore dhe administrative dhe ia paraqet Senatit;
 - b. harton raportin vjetor të veprimtarisë mësimore-kërkimore dhe financiare dhe ia paraqet atë për miratim senatit akademik dhe këshillit të administrimit brenda muajit dhjetor të çdo viti;
 - c. harton programin vjetor të veprimtarive, si dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në senatin akademik; formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore;
 - d. shqyrton paraprakisht planin buxhetor vjetor dhe atë afat mesëm të institucionit dhe i paraqet rekomandimet përkatëse në senat;
 - e. shqyrton paraprakisht planet dhe programet mësimore të paraqitura nga drejtuesit e njësive kryesore dhe ia përcjell senatit;
 - f. ndjek në vazhdimësi aktivitetin akademi dhe paraqet propozimet përkatëse për ndryshimet e nevojshme në funksion të përmbushjes së standardeve të cilësisë;
 - g. monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të institucionit;
 - h. parashtron përparësitë e kërkesave konkurruese për financime mes njësive kryesore të institucionit;
 - i. propozon strukturën dhe numrin e personelit për të gjitha nivelet e institucionit;
 - j. paraqet rekomandime për projektet dhe programet e studimeve, të kërkimit shkencor dhe ndryshimet e nevojshme strukturore për realizimin e tyre;
 - k. zbaton të gjitha vendimet e miratuara nga senati akademik;
 - l. përgatit rregulloren e tij të punës, që miratohet nga senati akademik.

Neni 22

Dekanati

1. Dekanati në institucionet e arsimit të lartë është organ kolegjal që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga:
 - a. Dekani;
 - b. Administratori i njësisë kryesore;
 - c. Drejtuesit e njësive bazë;
2. Funksionet kryesore të dekanatit janë si më poshtë:
 - a. Dekanati harton planin strategjik të zhvillimit të njësisë kryesore, mbështetur në propozimet e njësive bazë të tij;



- b. Dekanati koordinon veprimtarinë e njësive bazë;
- c. Harton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së njësisë kryesore dhe ia përcjell rektoratit;
- d. Harton planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore shkencore të njësisë kryesore të cilin ia paraqet raktoratit për vlerësim dhe ndjek zbatimin e tij pas miratimit në senat;
- e. Shqyrton paraprakisht plan buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të njësisë kryesore dhe paraqet rekomandimet përkatëse në Rektorat;
- f. Shqyrton planet dhe programet mësimore të paraqitura nga drejtuesit e njësive bazë dhe ia paraqet rektoratit për vlerësim;
- g. Ndjek në vazhdimësi aktivitetin akademik të njësisë kryesore dhe bën propozimet për ndryshimet e nevojshme në funksion të përmbushjes të standardeve të cilësisë;
- h. Monitoron dhe publikon rezultatet e vlerësimit të veprimtarive të njësisë kryesore.

Neni 23

Këshilli i Etikës

1. Pranë KU "I BIZNESIT" ngrihet Këshilli i etikës, i cili shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, si dhe në veprimtaritë e tjera institucionale.
2. Këshilli i etikës përbëhet nga tre anëtarë, të cilët emërohen nga Senati Akademik. Njëri nga anëtarët e tij emërohet nga Senati Akademik si kryetar i Këshillit të etikës.
3. Anëtarët e këshillit të etikës janë përfaqësues nga stafi akademik, studentë dhe nga organe drejtuese të KU "I BIZNESIT".
4. Këshilli i etikës shqyrton dhe merr vendime mbi çështje që parashtrohen nga personeli akademik dhe administrativ i KU "I BIZNESIT" si dhe nga studentët lidhur me etikën e studentëve, të personelit akademik dhe personelit administrativ.
5. Të drejtat, detyrat, organizimi dhe funksionimi i tij përcaktohen në rregulloren e institucionit.

Neni 24

Autoritetet drejtuese akademike

Autoritetet drejtuese akademike janë:

- a) Rektori;
- b) Drejtuesi i njësisë kryesore;
- c) Drejtuesi i njësisë bazë.

Neni 25

Rektori

1. Rektori është autoriteti më i lartë akademik dhe përfaqësuesi ligjor dhe protokollar i KU "I BIZNESIT" konform legjislacionit në fuqi.
2. Rektori mban titullin "Profesor".



3. Rektori zgjidhet nga Senati mes kandidatëve që vijnë nga radhët e personelit akademik të KU "I BIZNESIT" ose nga jashtë tij. Kandidatët konkurrojnë me dosje personale.
4. Procesi i zgjedhjes së Rektorit administrohet nga një komision *ad hoc*, i përbërë prej 5 anëtarësh të caktuar nga Senati Akademik. Ky komision vlerëson kandidaturat e paraqitura në bazë të kriterëve dhe kushteve ligjore. Komisioni organizon procesin e votimit dhe shpall fituesin.
5. Rektori zgjidhet me shumicën e të gjithë anëtarëve të Senatit Akademik. Njëri nga Dekanët caktohet Zv.Rektor.
6. Mandati i rektorit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
7. Mandati ndërpritet para përfundimit kur rektori:
 - a. dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - b. jep dorëheqjen;
 - c. është në pamundësi për të kryer detyrën;
 - d. janë konstatuar shkelje të rënda të ligjit ose Kodit të Etikës;
 - e. nuk është më pjesë e KU "I BIZNESIT".
8. Procesi i shkarkimit të Rektorit iniciohet me kërkesë të jo më pak se 1/5 e anëtarëve të Senatit Akademik. Votimi për shkarkimin e Rektorit bëhet me 3/5 e votave të Senatit.

Neni 26

Funksionet e Rektorit

Funksionet kryesore të Rektorit janë si më poshtë:

- a. Rektori drejton Senatin Akademik dhe raporton para tij;
- b. i paraqet senatit planin strategjik të zhvillimit;
- c. është anëtar i konferencës së rektorëve;
- d. ka të drejtën të informohet nga autoritetet drejtuese të të gjitha njësive për vendimet dhe masat e marra prej tyre;
- e. shfuqizon kryesisht apo me kërkesë të të interesuarit aktet e dekanit kur ato bien ndesh me kushtetutën, Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë & Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë", statutin, rregulloren dhe legjislacionin tjetër në fuqi;
- f. nënshkruan, diplomat e përfundimit të studimeve, pa pasur të drejtën e delegimit të firmës personave të tjerë. Rektori nënshkruan kontratat e punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik në institucionet e arsimit të lartë;
- g. jep leje për hyrjen e forcave të rendit në mjediset universitare dhe mund t'i thërrasë ato në rast nevojë;
- h. ka të drejtën e delegimit të firmës personave të tjerë vartës të tij. Në rast mungese i delegon kompetencat, ose një pjesë të tyre, zëvendësrektorit;
- i. ngre komisione e grupe për çështje, studime e veprimtari të veçanta;
- j. emëron dekanët e fakulteteve, zëvendësrektorët si dhe përgjegjësit e departamenteve, degëve dhe zyrave të nivelit ndihmës akademik;



- k. zgjidh në mënyrë përfundimtare mosmarrëveshjet mes dekanit dhe përgjegjësit të departamentit apo dhe mes dy dekanëve;
- l. miraton masën disiplinore të përjashtimit të studentëve nga Kolegji për rastet e parashikuara në rregulloret e fakulteteve dhe Kodin e Etikës;
- m. i kërkon informacion bordit të administrimit për çështje të kompetencës së këtij organi;
- n. jep dhe miraton masat disiplinore për punonjësit, deri në largimin e tyre nga puna kur shkelen nenet e statutit, të Kodit të Punës dhe Kodit të Etikës;
- o. miraton promocionet, dekorimet e punonjësve në përputhje me Legjislacionin e Republikës së Shqipërisë;
- p. lidh dhe zhvillon marrëdhënie kooperimi në fushën akademike me persona dhe institucione brenda dhe jashtë vendit;
- q. në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë & Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën Shqipërisë, kur me veprimet ose mosveprimet e tij, dekani shkel në mënyrë të përsëritur aktet ligjore, nënligjore, statutin, apo rregulloret e institucionit, në rastet e kryerjes së veprave penale flagrante ose të shkeljeve të rënda të ligjit, të pamundësisë për të kryer detyrën dhe për rastet e parashikuara në Kodin e Etikës, rektori shkarkon dekanin dhe përgjegjësin e departamentit;
- r. emëron dhe shkarkon drejtuesit e njësive bazë me propozim të drejtuesit të njësisë kryesore;
- s. ushtron të gjitha funksionet e tjera të përcaktuara në këtë statut dhe në akte të tjera normative të institucionit.

Neni 27

Drejtuesi i njësisë kryesore

1. Drejtuesi i njësisë kryesore është dekani.
2. Dekani është autoriteti më i lartë akademik i njësisë kryesore dhe përfaqësuesi i saj.
3. Ai koordinon veprimtarinë e njësisë bazë dhe organeve kolegiale të njësisë kryesore dhe zgjidh mosmarrëveshjet midis tyre.
4. Kandidati për Dekan duhet të mbaj titull akademik të kategorisë “Profesor”. Dekani emërohet nga Rektori nga lista e kandidatëve të paraqitur sipas një procedure konkurrimi të hapur. Rektori ngre një Komision *ad hoc*, i cili verifikon nëse kandidatët e paraqitur plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore të vendosura. Në përzgjedhjen e dekanit, rektori merr parasysh edhe një platformë të drejtimit të fakultetit që duhet të paraqesë çdo kandidat.
5. Mandati i Dekanit zgjat katër vjet. Ai shërben në detyrë për një mandat, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit ai vazhdon të jetë anëtar i personelit të njësisë bazë ku kryen veprimtarinë e tij akademike.
6. Marrëdhëniet e tij me institucionin përcaktohen në kontratën e punës. Në rast se dekani është në pamundësi të përkohshme për të kryer detyrën e tij, ai ia delegon kompetencat me shkrim njërit prej drejtuesve të njësisë bazë.



Neni 28

Funksionet kryesore të drejtuesit të njësisë kryesore

Dekani i Fakultetit ka këto funksione dhe detyra:

- a. drejton dhe kontrollon gjithë punën mësimore shkencore të fakultetit, siguron zbatimin e planeve dhe programve të mësimdhënies si dhe kalendarin akademik të fakultetit;
- b. transmeton dhe zbaton politikën e zhvillimit të fakultetit në përshtatshmëri me atë të institucionit;
- c. drejtuesi i njësisë kryesore i përcjell Senatit Akademik propozimet e njësive bazë, shoqëruar me mendimet e tij;
- d. në përfundim të vitit akademik, ose kur i kërkohet i paraqet Rektorit raportin mbi veprimtarinë e fakultetit dhe planin e aktiviteteve, në fakultet për vitin pasardhës;
- e. përgatit planin e buxhetit të fakultetit për vitin e ardhshëm;
- f. organizon dhe drejton punën për hartimin e planeve dhe programeve mësimore të cikleve të ndryshme të studimit dhe ja paraqet Rektorit;
- g. mbikëqyr përzgjedhjen e studentëve të rinj që pranohen çdo vit akademik;
- h. nënshkruan, diplomat e përfundimit të studimeve në njësinë përkatëse kryesore, pa patur të drejtën e delegimit të firmës personave të tjerë.
- i. miraton planet mësimore dhe kërkimore për anëtarët e personelit akademik të fakultetit;
- j. miraton komisionet e pranimit, kalendarët e provimeve dhe i propozon Rektorit, komisionin e provimeve të formimit dhe të mbrojtjes së diplomës;
- k. miraton tezat e provimeve të formimit dhe temat e projektdiplomave;
- l. përgatit dhe harton planin e aktiviteteve në fakultet për vitin akademik pasardhës.

Neni 29

Drejtuesi i njësisë bazë

1. Drejtuesi i njësisë bazë është përgjegjësi i departamentit.
2. Ai është autoriteti drejtues akademik i asaj njësie dhe e përfaqëson atë. Drejtuesi i njësisë bazë duhet të ketë të paktën gradën shkencore Doktor dhe të jetë i punësuar me kohë të plotë në institucion.
3. Drejtuesi i njësisë bazë emërohet dhe shkarkohet nga Rektori me propozimin e drejtuesit të njësisë kryesore. Mandati i tij zgjat 4 vjet me të drejtën e rizgjedhjes vetëm një herë.

Neni 30

Funksionet e drejtuesit të njësisë bazë

Drejtuesi i njësisë bazë ka këto funksione:

- a. i përcjell drejtuesit të njësisë kryesore propozimet e njësive bazë;
- b. drejton aktivitetin mesimor dhe shkencor të njësive;
- c. drejton punën për hartimin e rregullores së njësive bazë dhe i propozon drejtuesit të njësive kryesore miratimin e saj;



- d. drejton punën për hartimin e planeve dhe programeve të njësisë bazë dhe siguron zbatimin e tyre;
- e. miraton planet mësimore dhe planet kërkimore të personelit akademik të njësisë bazë;
- f. miraton tezat e provimit të lëndëve mësimore që zhvillon departamenti.
- g. ushtron çdo funksion tjetër të parashikuar në këtë statut dhe në rregullore;
- h. në rastet kur përgjegjësi i departamentit është në pamundësi të përkohshme për të kryer detyrën e tij, ai ia delegon kompetencat një antari të stafit akademik;

KREU IV

ORGANIZIMI ADMINISTRATIV

Neni 31

Bordi i Administrimit

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Neni 32

Përbërja dhe krijimi i Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit përbëhet nga 3 anëtarë, që caktohen nga asambleja e shoqërisë KU "I BIZNESIT". Antarët e Bordit të Administrimit nuk mund të jenë antare të Senatit Akademik. Në përbërje të Bordit të Administrimit caktohen përfaqësues të asamblesë, personel akademik të brendshëm apo të jashtëm të propozuar nga senati, që kanë ekspertizën e nevojshme dhe janë të njohur në fushën menaxheriale, ekonomike dhe juridike. Anëtarët e Bordit të Administrimit kanë mandat pesëvjeçar me të drejtë rimandatimi. Rektori dhe administratori marrin pjesë në mbledhjen e Bordit të Administrimit pa të drejtë vote.

Neni 33

Organizimi i Bordit të Administrimit

Bordi i Administrimit mbledhet sa herë lind nevoja për çështjet e Administrimit dhe financiare, por jo më pak se 3 herë në vit.

Neni 34

Mbledhja e Bordit të Administrimit

Mbledhjet e Bordit të Administrimit janë të rregullta dhe merren vendime, kur janë të pranishëm në takim 2/3 e antarëve. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash.



Neni 35

Funksionet e Bordit të Administrimit

1. Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore:
 - a. garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë dhe përmbushjen emisionit të tij;
 - b. me propozim të Senatit Akademik, miraton planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhembikëqyr zbatimin e tij;
 - c. me propozim të senatit miraton buxhetin vjetor dhe atë afatmesëm të institucionit dhe mbikqyr zbatimin e tyre;
 - d. me propozim të senatit akademik miraton numrin e personelit në të gjitha nivelet;
 - e. vlerëson paraprakisht mbylljen ose riorganizimin e institucionit si dhe ndarjen apo bashkimin e institucionit me një institucion tjetër të arsimit të lartë.
 - f. miraton paraprakisht hapjen, riorganizimin ose mbylljen e njësive përbërëse dhe degëve të institucionit brenda dhe jashtë vendit(degë);
 - g. jep mendim për rregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;
 - h. përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni dhe mbikqyr përdorimin e burimeve të financimit;
 - i. përcakton kriteret dhe procedurat për punësimin e administratorëve dhe punonjësve administrativë;
 - j. emëron dhe shkarkon administratorin e institucionit dhe, nëse e vlerëson të nevojshme si paosjë e ngarkesës së punës, autorizon administratorin e institucionit për emërimin e administratorëve të njësive kryesore;
 - k. miraton paraprakisht statutin para se t'i përcillet Senatit Akademikmiraton raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit të hartuar nga Rektorati;Bordi i Administrimit ushtron çdo funksion tjetër të parashikuar në këtë statut

Neni 36

Autoritetet drejtuese administrative

Autoritetet drejtuese administrative janë:

- a. Administratori i institucionit;
- b. Administratori i njësisë kryesore (në rast emërimi nga Bordi i Administrimit);

Neni 37

Administratori i KU "I BIZNESIT"

1. Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit.



2. Administratori është përfaqësues ligjor i KU "I BIZNESIT" për çështjet financiare dhe administrative. Ai mund të delegojë funksionet e tij.
3. Administratori emërohet nga Bordi i Administrimit dhe duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin "Master i shkencave" në fushën e drejtësisë ose ekonomisë dhe përvojë pune së paku shtatë vjet në këto fusha.
4. Administratori nuk mund të ushtrojë asnjë funksion tjetër, akademik apo administrativ.
5. Administratori i raporton për veprimtarinë e tij Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik, sipas përcaktimeve të këtij statuti.

Neni 38

Funksionet e administratorit

Administratori ka këto funksione:

- a. harton projekt buxhetin vjetor, mbi bazën e propozimeve të njësive kryesore dhe të njësive bazë, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe në planin buxhetor afatmesëm të tij;
- b. propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare dhe materiale, të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Administrimit dhe mbikëqyr shpërndarjen e zbatimin e tyre;
- c. ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit të arsimit të lartë në strukturat evarësisë së tij;
- d. zbaton të gjitha vendimet e Bordit të Administrimit dhe të Senatit Akademik me karakter financiar dhe administrativ;
- e. i paraqet Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik raportin mbi veprimtarinë financiare të institucionit të arsimit të lartë, në përfundim të vitit akademik;
- f. bashkëpunon me strukturat dhe autoritetet e tjera të institucionit të arsimit të lartë për çështje të administrimit të përditshëm;
- g. plotëson kërkesat e rektorit, me qëllim përmbushjen e nevojave akademike, administrative dhe financiare.

Neni 39

Financimi

1. Institucioni KU "I BIZNESIT" financohet nga burimet e veta, të ardhurat që mblidhen nga tarifat e pranimit të studentëve dhe të ardhura të tjera që krijohen nga shërbime të ndryshme, studime e projekte, që kryhen në këtë Institucion, në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij, si dhe nga kontributet dhe donacionet e themeluesve por dhe burime të tjera të ligjshme.
2. Fondet për kërkimin shkencor përcaktohen si zë më vete në buxhetin e institucionit KUB.



